



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi
Mbledhja nr. 38
Prishtinë, më 14 dhjetor 2009, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Armend Zemaj, Ibrahim Makoll, Adem Salihaj dhe Vladimir Todorović.

Munguan: Mufëra Şinik dhe Kolë Berisha.

Të pranishëm: Trim Kabashi – ICO, Siv Katrine Leirtry – ICO, Bajram Gecaj – USEP, president, Lumnije Murati – ZPRK, Shqipe Arifaj – Asociacioni i Komunave të Kosovës, Jetmir Bakija – Konsorciumi KDI – Birn, Behar Xharra – UNDP, Lejla Selimi – OSBE dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 dhjetorit 2009;
3. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe Komisionit për Kthim dhe Komunitete lidhur me Projektligjin kundër korrupsionit;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit;
5. Të ndryshme,
- Shqyrtimi i kërkesës së avokates Myrvete Çollaku nga Prizreni.

Kryetari konstatoi se ish-in plotësuar kushtet dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit, mbikëqyrësit e punës së Komisionit dhe propozoi të fillohej me rendin e ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 1 dhjetorit 2009

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Kthim dhe Komunitete lidhur me Projektligjin kundër korrupsionit

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit për Raportin e Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të Komisionit për Kthim dhe Komunitete, me të cilin Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim e ka shqyrtuar Projektligjin kundër korrupsionit dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve. As amendamentet e tij nuk i cenojnë dhe nuk i prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandoi Kuvendit ta miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara. Ndërsa Komisioni për Buxhet dhe Financa e shqyrtoi Projektligjin kundër korrupsionit dhe konstatoi se dispozitat e tij dhe amendamentet e Komisionit Funkcional – Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi, nuk përmbajnë implikime buxhetore.

Meqë nuk pati vërejtje Projektligji së bashku me amendamentet e miratuara nga Komisioni procedohet për shqyrtim dhe për miratim në një nga seancat e radhës së Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve në Projektligjin për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Kryetari - Tha se në takimin e javës së kaluar jemi pajtuar me disa propozimamendamente, kurse sot do të përpiqemi t'i bëjmë disa riformulime të amendamenteve, duke u përqendruar në çështjet përmbajtjesore.

Bajram Kosumi - Propozoi që amendamenti 3, neni 6.1, të riformulohet: “*deputeti nuk mund të jetë njëkohësisht*” dhe teksti vazhdon si në ligj.

Kryetari - Kërkoj nga anëtarët të përqendrohen në amendamentin 16, neni 23, sepse pasi i kishin konsultuar ekspertët për buxhet dhe financa, e kishin riformuluar këtë nen, sepse ashtu siç ishte më parë ishte e pamundur të hynin edhe legjislaturat para vitit 2001. I ftoi anëtarët e Komisionit t'i shprehnin mendimet rreth këtij amendamenti.

Adem Salihaj - Tha se e mbronte qëndrimin që ky nen të mbetej, ashtu siç ishte në Projektligj.

Ibrahim Makolli - Tha se nuk mund të thuhet: “që nga legjislatura e parë e vitit 2001”, sepse kjo nuk është legjislaturë e parë. Shtoi se do të ishte mirë që të shikohet mundësia që me një ligj të veçantë të rregullohen legjislaturat e viteve 1990,1992,1998.

Armend Zemaj - Shprehu mendimin se legjislaturat e kaluara mbeten legjislatura të shtetit dhe do të duhej të mbeteshin në këtë projektligj. Prandaj duhet të shqyrtohet me vëmendje kjo çështje.

Selvije Halimi - Tha se do të ishte mirë që çështja e legjislaturave të kaluara të rregullohet me ligj të veçantë dhe ne si Komision ta hartojmë këtë ligj.

Bajram Kosumi - Propozoi t'i lëmë të hapura këto dy mundësi - edhe nenin 23 të Projektligjit, edhe amendamentin - në mënyrë që të kërkojmë nga Kryesia të diskutohet kjo çështje edhe të marrim qëndrim të përbashkët.

Armend Zemaj - Duke folur për legjislaturat para vitit 1999, theksoi se do të ishte mirë ta kishim një pasqyrë më të qartë për numrin e ish-deputetëve, në mënyrë që të shohim sa mund të përballohet kostoja buxhetore.

Ibrahim Makolli – Sërish tha se do të ishte mirë që si Komision t'i propozonim dy amendamente dhe seanca plenare të vendosë se cili prej tyre kalon. Shtoi se legjislaturat para vitit 1999 janë të lidhura me legjislaturat pas këtij viti dhe është shumë vështirë t'i shkëpusim nga ajo kohë. Tha se më mirë është të mos nxjerrim fare ligj për deputetin, përdërisa nuk krijohen kushte politike dhe ekonomike, se sa ta mohojmë një pjesë të asaj kohe, së cilës i kemi takuar.

Kryetari - Propozoi që ta bëjmë një amendament dhe me shkresë, me të cilën do të kërkojmë qëndrim politik rreth kësaj çështjeje, t'u drejtohem Kryesisë dhe grupeve parlamentare.

Adem Salihaj - Tha se nëse i dërgojmë Kryesisë shkresë për një mendim rreth unifikimit të kësaj çështjeje, atëherë do të duhej të shkonin të dy formulimet, edhe amendamenti, edhe versioni, siç është në Projektligj, sepse unë jam për qëndrimin që të mbetet siç ka qenë. Shtoi se kjo rrugë është e komplikuar, sepse nuk mund t'i ikim debatit në Kuvend rreth kësaj çështjeje.

Ramadan Gashi – Tha se do të ishte mirë, nëse e fusim në ligj, që statusi i ish-deputetëve të rregullohet me ligj të veçantë, si Komision ta marrim për obligim hartimin e këtij ligji.

Pas një diskutimi të gjerë, që u zhvillua, Komisioni njëzëri i miratoi amendamentet 1, 2, 4, 5, 6, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 17, 18, 19, 21, 22, 23, 24, 26.

Amendamenti 7 hiqet, ndërsa nenet 31, 34 dhe 41 i Projektligjit hiqen.

Kryetari - Propozoi që riformulimi lidhur me nenin 23 të ndahet në dy paragrafë dhe të riformulohet si vijon:

Të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit të përcaktuara me këtë ligj do të fillojnë të zbatohen nga legjislatura e vitit 2001.

Statusi i deputetëve të legjislaturave të viteve 1990 deri 2001, do të rregullohet me ligj të veçantë.

Propozimi u miratua me shumicë votash, ndërsa kundër këtij amendamenti votuan Adem Salihaj dhe Armend Zemaj.

Ibrahim Makolli - Propozoi që me amendament të hiqet neni 32.2 i Projektligjit, sepse nuk ka nevojë të hyjë formulimi në të cilin thuhet se, në vizitë të përbashkët zyrtare, bashkëshortes ose bashkëshortit të deputetit, duhet t'i krijohen lehtësi për vizë, sepse për vizitë zyrtare, të dy duhet të pajisen me viza zyrtare.

Adem Salihaj – Sërish iu referua nenit 39, amendamenti 25, lidhur me sigurinë e deputetit. Tha se së pari duhet të bëhet e qartë a trajtohet deputeti, si çdo qytetar në aspektin e sigurisë, sepse është funksionar i lartë politik dhe është më i rrezikuar se qytetari. Në vazhdim e krahasoi deputetin me ministrin. Vuri në pah se nuk ndiqen procedura të njëjta të sigurisë si për ministrin, i cili mund të sigurojë mbrojtje brenda ditës, kurse deputeti nuk mund ta realizojë këtë. Deputeti, për të siguruar mbrojtje, duhet t'i bëjë kërkesë drejtorit të Policisë së Kosovës. Ekipet e saj vlerësojnë a ka arsye të mjaftueshme për një gjë të tillë. Prandaj deputeti duhet trajtohet ndryshe, jo siç është përcaktuar në këtë amendament.

Ibrahim Makolli - U pajtua me parafolësin se deputeti dhe qytetari nuk trajtohen njësoj dhe as procedurat nuk janë të njëjta. Propozoi të shikohet mundësia që kërkesa për sigurinë e deputetit të realizohet nëpërmjet kryetarit të Kuvendit, sepse nuk ka procedura të veçanta. Propozoi të riformulohet kështu: *“Deputetit, në pajtim me procedurat për mbrojtje të veçantë, t'i sigurohet mbrojtje e veçantë nga autoritetet e Policisë së Kosovës”*. Lidhur me nenin 51 të Projektligjit tha se duhet t'i referohemi Ligjit për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Armend Zemaj - U pajtua me parafolësit se kjo çështje duhet të shikohet me kujdes, sepse do të duhej të kishte procedura të tjera dhe trajtim më të veçantë për sigurinë e deputetit.

Selviqe Halimi - Tha se nuk mund të kërkojmë nga Policia të trajtohem si të veçantë. Me Rregulloren e brendshme të Policisë do të duhej të parashiheshin lehtësi për deputetët, si funksionarë politikë. Në të kundërtën nuk mund të kërkojmë trajtim të veçantë nga Policia e Kosovës.

Bajram Kosumi - Propozoi që në nenin 39 të bëhet ky riformulim: *“Kërkesa e deputetit për mbrojtje të afërt të vlerësohet nga Policia në procedurë të përsheptuar”*.

Kryetari - Sipas propozimeve të anëtarëve të Komisionit e riformuloi nenin 39 si vijon:

Deputetit t'i sigurohet mbrojtje e veçantë nga organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, në pajtim me procedurat për mbrojtje të veçantë në rastet kur e kërkon këtë. Për kërkesën e deputetit për sigurimin e mbrojtjes së veçantë vendos Ministria e Punëve të Brendshme në procedurë të përshpejtuar.

Projektligji, së bashku me amendamentet e miratuara nga Komisioni, i dërgohet Sektorit të Buxhetit të Kuvendit që të nxjerrë deklaratë financiare dhe pastaj të procedohet në komisionet e tjera funksionale të Kuvendit.

Të ndryshme

- Shqyrtimi i kërkesës së avokates Myrvete Çollaku nga Prizreni.

Komisioni e shqyrtoi kërkesën e Myrvete Çollaku nga Prizreni. Konstatoi se kjo çështje nuk i përket fushëveprimit të Komisionit dhe i rekomandoi t'i drejtohet Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Kosovës.

E hartoi:

Stafi Mbështes i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni